



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

PROJEKT-VENDIM

Nr. datë, .2025

PËR

“ MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PIKËS 4 TË VKB NR.36, DATË 13.03.2025 TË ZËRAVE E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT PËR FONDIN E KUSHTËZUAR TË MBROJTES CIVILE , BASHKIA KOLONJË PËR VITIN 2025.

Ligji Nr .139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, Ligji nr 45/2019”Për Mbrojtjen Civile”, Ligji Nr.57/2020 “Për pyjet”, VKM nr.414,datë 8.7.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushëtuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, Ligji Nr.9936,datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr .68,datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, Udhëzimit Nr.9, datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të hartimit të buxhetit”. Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës .08.2025

I PROPOZOJ:

- 1.Të miratoj ndryshimin e shumës së planifikuar tek pika 4, shpenzime për marrjen e masave, rehabilitim mbrojtje lumore me shumën e planifikuar 1,800,000 lekë.
- 2.Shuma prej 1,000,000 lekë, e cila do të kalojë në rehabilitim, mbrojtje lumore.
- 3.Shuma 800,000 lekë, do të kalojë në masa parandaluese duke siguruar kalueshmërinë në koridoret pyjore.
- 4.Për zbatimin e tij ngarkohet Drejtoria e Financës,Drejtoria e Çëshjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike, Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit në Bashkinë Kolonjë.
- 5.Kopje e këtij vendimi do të dërgohet për verifikim ligjshmërie tek Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.
- 6.Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Korçë.

**TABELA PËR SHPENZIMET E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR MBROJTJEN CIVILE,
BASHKIA KOLONJË**

Nr	Zërat e shpenzimeve të buxhetit për fondin e kushtëzuar të Mbrojtjes Civile	Shuma e planifikuar	% ndaj buxhetit total për MC	Shuma e shpenzimeve faktike	% ndaj buxhetit total për MC	Shuma e mbetur
1	Ndihmë financiare për familjet e dëmtuara. 1.Ndihmë financiare znj. Fatime Çinari,banesa e te ciles u prek nga zjarri. 2.Ndihmë financiare famijeve që mund të preken nga fatkeqësitë.	1,000,000.64 lekë 853,761.5 lekë 146, 239.14 lekë	29%			
2	Mbajtjen në gadishmëri për kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve.	200, 000 lekë	6 %			
3	Për plotësim të strukturave me pajisje.	399, 491 lekë	12%			
4	Shpenzime për marrjen e masave; 1.Rehabilitim , mbrojtje lumore.	1, 000, 000 lekë	29%			
5	Shpenzime për marrjen e masave ; 1.Parandalim , izolim i zjarreve në pyje, krijimi i një rruge pyjore në fshatin Radanj, në ekonominë pyjore Leskovik.	800,000 lekë	24%			
	Shpenzime në total					
	Buxheti total për vitin 2025 për Mbrojtjen Civile	3, 399, 491.64 lekë	100 %			

**KRYETARI
Erion ISAI**

**NË MUNGESË DHE URDHËR
NËNKRYETAR**

Petro Risto





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 4220 prot

Datë, më 12.08.2025

RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIM

Nr. datë, . 2025

PËR

“ MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PIKËS 4 TË VKB NR.36, DATË 13.03.2025 TË ZËRAVE E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT PËR FONDIN E KUSHTËZUAR TË MBROJTJES CIVILE , BASHKIA KOLONJË PËR VITIN 2025.

Të nderuar këshilltarë!

Drejtoria e Emergjencave Civile, Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, Drejtorinë e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit në bashkëpunim me drejtoritë dhe sektorët e Institucionit të bashkisë Kolonjë, duke ju referuar situatës së krijuar dhe rishikuar për shpenzime për marrjen e masave, rehabilitim mbrojtje lumore, si dhe të VKB nr 36 datë 13.03.2025 . Mbështetur në nenin 54 në detyrat dhe kopetencat që ka Këshilli Bashkiak si dhe në bazën ligjore:

Ligji Nr .139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Ligji Nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”,

Ligji Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”

Ligji Nr.57/2020 “Për pyjet”

VKM nr.414, datë 8.7.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushëtzuat të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

Ligji Nr .68, datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore”.

Udhëzimit Nr.9, datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të hartimit të buxhetit”.

Fondi i kushtëzuar për mbrojtjen civile për vitin 2025 është planifikuar të përdoret sipas zërave të shpenzimeve qëllim:

Zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të kuadrit ligjor.

Gjatë zbatimit të shpenzimeve të këtij fondi, për pikën 4 të VKB Nr.36, datë 13.03.2025 shuma e planifikuar ka qënë në masën 1,800,000 lekë, me destinacion shpenzime për marrjen e masave për rehabilitim mbrojtje lumore në fshatrat Qafzez, Gostivisht. Lidhur me këtë ndryshim u mor në konsideratë, vlerësimi i bërë në terren, preventivi i hartuar dhe i miratuar më datën 15.07.2025.

Ndryshimet e propozuara janë si më poshtë:

- 1.Të bëhet ndryshimi i shumës së planifikuar tek pika 4, shpenzime për marrjen e masave rehabilitim mbrojtje lumore me shumën e planifikuar 1,800,000 lekë.
- 2.Shuma prej 1,000,000 lekë do të kalojë në rehabilitim, mbrojtje lumore.
- 3.Shuma 800,000 lekë, do të kalojë në masa parandaluese duke siguruar kalueshmërinë në koridoret pyjore në fshatin Radanj, në njësinë ekonomike pyjore Leskovik, duke ju referuar projektit të hartuar nga Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, për masat mbrojtëse në zonën kadastrale 3134, ngastra/nëngastra 138/a, pronë Bashkiake, si pasojë e zjarrit të rënë më datën 17.07.2025 në fshatin Radanj, Njësia Administrative Qëndër Leskovik. Shkak i zjarrit në këtë mjedis ishte goditja nga rrufeja, me sipërfaqe rreth 200 m². Gjatë ndërhyrjes me forcat dhe mjetet pati probleme në kalimin e mjeteve zjarrfikëse dhe mjeteve të tjera të cilët morrën pjesë në izolimin dhe fikjen e zjarrit, por dhe situatave të zjarreve të rënë në këtë njësi administrative. Ky projekt i hartuar nga inxhinjerët e pyjeve do të dërgohet për miratim në Ministrinë e Mjedisit dhe më pas do të ndiqen procedurat ligjore.
- 4.Për zbatimin e tij ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Çëshjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike, Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit në Bashkinë Kolonjë.

Për të gjitha arsyet e trajtuara më sipër, propozojmë:

- 1.Miratimin e ndryshimit për shpenzime të përdorimit të fondit të kushtëzuar, pikës 4 të VKB Nr. 36, datë 13.03.2025 në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile për bashkinë Kolonjë.

Duke **Ju** falënderuar.

Konceptoi: E.Guçe
J.Duka
Pranoi: M.Gora
Miratoi: E.Zylfo
Konfirmoi: D.Ç.J.P.P O.Lifo

KRYETARI

Erion Isai

NË MUNGESË DHE URDHËR

NËNKRYETAR

Petro Risto

Adresa: Sheshi "Rilindja", 7401, Ersekë, Kolonjë, ëëë. Kolonja, ëëë.kolonja.gov.al, email: info@kolonja.gov.al